



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 140/2021

Data: 10 mars 2021

Në bazë të nenit 7 paragrafi 1, nënparagrafi 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me qëllim të zbatimit të nenit 5 paragrafi 1.9 të Udhëzimit Administrativ për Sigurimin, Ruajtjen, Qasjen, dhe Rendin në Objektet e Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, dhe me qëllim të realizimit të efikasitetit të palëve në procedurë, lëshohet ky:

Udhëzues për Qasjen e Avokatëve në Objektet e Sistemit Prokurorial

- I. Të gjithë avokatët të cilën janë të anëtarësuar pranë Odës së Avokatëve të Kosovës, të cilët janë të angazhuar për të mbrojtur klientët e tyre në procedurën penale apo janë të ftuar nga prokurori i Shtetit për qasje në objektet e sistemit prokurorial duhet të lajmërohen fillimisht te recepcionisti për njoftim për takimin e planifikuar me prokurorin.
- II. Pas konfirmimit nga ana e prokurorit të çështjes, avokati shoqërohet deri tek zyra e prokurorit nga zyrtari përgjegjës.
- III. Të regjistrohet koha kur ka hyrë avokati në objektin e prokurorisë, tek cili prokuror ka kërkuar takim.
- IV. Qasja e avokatëve në objektin e prokurorisë është e njëjtë sikurse për Policinë e Kosovës.
- V. Çantat dhe gjësendet e tyre personale duhet t'i nënshtrohen kontrollit me përparësi përmes skanerit.
- VI. Avokatët gjatë vizitës zyrtare detyrohen gjatë tërë kohës sa qëndrojnë në objektet e sistemit prokurorial të mbajnë kartelën zyrtare valide për identifikim në pjesë të dukshme të trupit.
- VII. Obligohen të gjitha prokuroritë në Republikën e Kosovës për zbatimin e këtij Udhëzuesi.

Jetish Maloku
Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës